



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.02/2018

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevci anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtares së Lartë Ligjore Antigona Murati duke vendosur lidhur me apelin e subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP) me seli ne Komunën e Prizrenit, të paraqitur kundër vendimit Nr.56/2018, të datës 12.01.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të çregjistrimit të subjektit politik nga Regjistri i Partive Politike të Regjistruara në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), në seancën e panelit të mbajtur me 24.01.2018, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si i pabazuar apeli i subjektit politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), me seli në Prizren, i paraqitur kundër vendimit Nr.56/2018 i datës 24.01.2018, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), me seli në Prishtinë.

A r s y e t i m

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa - PZAP, me datë 24.01.2018 ka pranuar një apel nga subjekti politik KTAP, të paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, me numër protokollit 56/2018 të datës 12.01.2018, me të cilën thekson se KQZ me datën 12.01.2017 ka marrë vendimin me nr.56/2018 për çregjistrimin e subjektit politik KTAP dhe këtë vendim e kanë pranuar më datë:22.01.2018 me të cilën pretendon se ky vendim ka vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimit të gabuar të dispozitave ligjore materiale dhe procedurale.

Parashtruesi i apelit thekson se subjekti i tyre politik “Kosova Turk Adalet Partisi-KTAP” me seli në Prizren, është parti politike e komunitetit turk të Kosovës e themeluar në vitin 2012, prej kur zhvillon veprimet aktivitetin e saj politik dhe shoqëror kryesisht në Komunën e Prizrenit, Mamushës, por edhe në të gjithë Kosovën dhe gjatë kësaj veprimtarie iu ka përmbajtur të gjitha obligimeve ligjore që janë përcaktuar me legjislacionin e aplikueshëm të Republikës së Kosovës. Në vazhdim thekson se KTAP gjatë kohës së ekzistimit të saj ka kryer edhe obligimin e saj ligjor për zgjedhjen e

organeve drejtuese të partisë, siç është dashur dhe është përgatitur ti zhvilloj edhe herën e fundit, me të cilën sipas tyre ka ndodhur një keqkuptim , një mos informim i duhur, dhe mos kuptim i saktë i obligimeve të saj.

Parashtruesi i apelit thekson se KTAP në emalin e tyre zyrtar më datë 23.11.2017 ka pranuar vendimin e dërguar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) të dt.23.11.2017, me të cilën është bërë pezullimi aktivitetit të partisë politike me arsyetimin për mos respektim të afatit ligjor për mbajtjen e Kuvendit Zgjedhor të partisë ashtu siç është parashikuar në bazë të ligjit për zgjedhjet dhe rregullës zgjedhore.

Lidhur me këtë email dhe vendimin për pezullim parashtruesi i apelit thekson se për shkak të mos kuptimit të saj të saktë pasi që e njëjta është shkruar vetëm në gjuhën shqipe, zyrtarët e partisë së tyre e kanë shkruar një letër informuese me të cilën bëhet e ditur se zgjedhjet do të mbahen në afatin sa më të shkurtër kohor si dhe kanë kërkuar ndihmë në organizimin e këtyre zgjedhjeve dhe kanë bërë sqarimin e vonesës së tyre për shkak të zgjedhjeve nacionale dhe lokale në Kosovë. Lidhur me këtë thekson se nuk kanë marrë asnjë përgjigje dhe asnjë sqarim lidhje me kërkesën për ndihmë dhe asnjë konfirmim për pranimin e arsytimit për vonesë apo mospranimin të tij, dhe është marrë vendim për çregjistrimin e partisë, pa iu dhënë mundësia që partia të informohet në gjuhën që e kupton për pasojat e mos mbajtjes së zgjedhjeve. Po ashtu thekson se zyrtarët e tyre kanë pranuar emailin në “spam”, e jo në inbox, ku do të shiheshin dhe do të merreshin parasysh, nga zyrtarët e partisë.

Parashtruesi i apelit pretendon se KQZ ka bërë shkeljen e dispozitave ligjore dhe kushtetuese të Republikës së Kosovës që kanë të bëjnë me përdorimin e gjuhëve, pasi që zyrtarët e partisë nuk kanë qenë në gjendje të kuptojnë shkresën me të cilën njoftohen për pezullim dhe pasojat e mos organizimit të zgjedhjeve në afatin e dhënë.

Kërkon nga PZAP-i që të bëhet anulimi i vendimit të atakuar, ashtu që ti mundësohet partisë që të mbaj Kuvendin e saj Zgjedhor, të cilin zyrtarët e strukturave ekzistuese zotohen se do ta bëjnë brenda 24 orëve, nga momenti që anulohet vendimi i atakuar dhe një gjë e tillë të kërkohet nga KQZ.

Apelit i ka bashkangjitur Vendimin mbi çregjistrimin e partisë politike 56/2018 si dhe emailin e dërguar në ZRPPC

Në përgjigjen në apel e ofruar nga KQZ-ZRPPC, me nr. Protokolli 116/2018 të datës 24.01.2018, thekson se sa i për ketë mënyrës së komunikimit të Zyrës për Regjistrimin e Partive Politike, Zyra me palën ankuese dhe të gjitha subjektet politike i njofton për të gjitha aktivitetet që ndërlidhen me afatet ligjore përmes postës elektronike-email-it, i cili email iu dërgohet kryetarit të partisë dhe personit kontaktues të të njëjtës parti. Sa i përket

Vendimit të KQZ-së të shkruar në gjuhën shqipe theksohet se zyra edhe më parë ka komunikuar me subjektin në fjalë në këtë mënyrë dhe asnjëherë nga ky subjekt nuk ka pasur ndonjë vërejtje sepse tërë dokumentacioni dërguar nga ky subjekt politik që ka garuar në zgjedhje është dorëzuar në gjuhën shqipe dhe bisedat telefonike është komunikuar në gjuhën shqipe pa ndonjë vërejtje nga përfaqësuesit e kësaj partie. Në vazhdim të përgjigjes ZRPPC lidhur me ndihmën e potencuar në kërkesën e subjektit të lartcekur e dërguar përmes emailit më datë 24.11.2017 se KTAP do të organizoj në afatin kohor sa më të shkurtër zgjedhjet e brendshme të partisë, thekson se ky afat është i ndërlidhur me afatin e shtuar me vendimin e KQZ-së të datës 23.11.2017 dhe nuk i kanë dërguar ndonjë njoftim tjetër pasi që vendimin për shtyrje të afatit (45 ditë) nga KQZ-ja e ka pranuar ky subjekt. ZRPPC në përgjigjen e tyre thekson se kjo parti politike sipas legjislacionit, gjegjësisht nenit 15 të Rregullës Zgjedhore 01/2013, kuvendin e saj zgjedhor ka qenë e obliguar të mbajë më datë 20.08.2017, (çdo 48 muaj) mirëpo, meqenëse kjo periudhë kohore ka qenë proces zgjedhor (aktivitetet për zgjedhjet lokale), të gjitha partive politike iu është shtyrë afati për mbajtje të Kuvendit Zgjedhor, pa marrë parasysh a ka bërë ankesë KQZ. Në përgjigje theksohet se KQZ, pas zgjedhjeve lokale (pas certifikimit të rezultateve), ka marr vendim për shtyrje të afatit të kuvendit zgjedhor të partisë së lartcekur që brenda 45 ditëve nga data 23.11.2017 të mbajë kuvendin e saj zgjedhor, si dhe mënyra e komunikimit me email ka qenë çdo herë pa ndonjë pengesë, prandaj nuk është vepruar ndryshe.

KQZ, në përgjigjen e saj si dëshmi ka bashkangjitur:

- Njoftimi elektronik i përfaqësuesve të partisë politike.

Paneli, ankesën e parashtruar nga pala ankuese e ka trajtuar si apel duke u bazuar në nenin 3 paragrafi 8 i Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it 02/2015, pasi që ka konsideruar se ankesa e dorëzuar do të trajtohet në mënyrën më të duhur si apelim.

PZAP-i, pas administrimit të pretendimeve ankimore, vendimit kontestues të datës 12.01.2018 me numër protokollit 56/2018 të KQZ-së dhe përgjigjes në apel të KQZ-ZRPPC-së gjeti se:

Apeli është i pabazuar.

PZAP, konstaton se KQZ-ja me vendimin me Nr.56/2018 të datës 12.01.2018, ka vendosur drejt kur ka bërë çregjistrimin nga Regjistri i Partive politike subjektin politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP).

Dispozita e nenit 15.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013 për Regjistrimin dhe Veprimin e Partive Politike ka përcaktuar që *“Partia e regjistruar politike mban kuvendin brenda gjashtë (6) muajve nga data e regjistrimit të partisë dhe pastaj së paku dyzet e tetë (48) muaj”*.

Paneli konstaton nga shkresat lëndës, se subjekti politik Kosova Turk Adalet Partisi (KTAP), nuk i ka përmbushur obligimet ligjore të cilat parashihen me nenin 15 par.1 të Rregullës Zgjedhore Nr.01/2013. Të cilat mos përmbushje ligjore i'ka pohuar edhe vetë parashtruesi i apelit. Po ashtu Paneli ka gjetur se KQZ-ja në pajtim me nenin 6 paragrafi 1, pika (aa), të Rregullës Zgjedhore 01/2013 me vendimin numër 2348/2017 të datës 23.11.2017 e ka pezulluar nga regjistri i partive politike duke i dhënë afat shtesë subjektit politik në fjalë që në afat të shtuar prej dyzet e pesë (45) ditësh, nga dita e pezullimit të mbaj kuvendin zgjedhor, i cili vendim është pranuar nga pala me kohë nëpërmjet emailit. Përkundër kësaj subjekti politik KTAP nuk ka vepruar sipas udhëzimeve të dhëna me vendimin e lartpërmendur të KQZ-së.

Lidhur me pretendimet se vendimi për pezullim në gjuhën shqipe dhe zyrtarët e tyre nuk kanë qenë në gjendje të kuptojnë shkresën me të cilën njoftohen për pezullim nuk është dëshmi e cila arsyeton palën për mos përmbushjen e obligimeve sepse Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) ka vepruar sipas nenit 4.2 të Ligjit Nr.02/L-37 Për Përdorimin e Gjuhëve.

Bazuar në këto që u theksuan më lartë PZAP konstaton se vendimi i KQZ-së me Nr.56-2018 i datës 12.01.2018, për çregjistrimin e subjektit politik KTAP nga regjistri i partive politike është i drejtë dhe i bazuar në nenin 8.1 pika e) Rregullës Zgjedhore 01/2013 pasi që subjekti politik në fjalë nuk vepruar sipas afatit të përcaktuar me vendimin e KQZ-së për mbajtjen e kuvendit zgjedhor, ndërsa pretendimet e parashtruara në apel janë të pabazuara.


Për arsyet e cekura si më lartë e në pajtim me nenin 115.1 lidhur më nenin 118.1 të LZP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr. 02/2018 më datën 24.01.2018

Kryesuesi i Panelit,

Hasan Shala



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur, mund të paraqet ankesë brenda afatit prej njëzet e katër (24) orëve, nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi në Gjykatën Supreme të Kosovës.